



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2022:226480

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05333305

C.nr. 469/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses: L. B. , nga fshati A... , Komuna e Drenasit, të cilën e përfaqëson i autorizuari Av. L. H. , avokat në P..., kundër të paditurës: K... e S... ‘S... ’, me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi, jashtë seancës gjyqësore me datë 09.02.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 31.10.2022, e paditëses L. B. , kundër të paditurës: K... e S. ‘S...’, me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësja përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 31.10.2022, kundër të paditurës: K... e S... ‘S...’, me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi.

I autorizuari i paditëses pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 21.12.2022, me parashtrësën e datës 01.02.2024, e ka njoftuar gjykatën që e tërheq padinë në raport me të paditurën, pasi që kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë,*

*deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. . Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.*

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe nenit 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË  
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil  
C.nr.469/22, datë 09.02.2024.

G j y q t a r j a:  
Fllanza Hashani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.